



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

AVOKATI I POPULLIT

RAPORT

I

MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS

**lidhur me vizitat në departamentet psikiatrike në kuadër të spitaleve regjionale në
Prizren, Gjakovë, Pejë dhe Gjilan**

- Për: Z. Arben Vitia, ministër në detyrë
Ministria e Shëndetësisë
- Kopje: Z. Elvir Azizi, drejtor i përgjithshëm
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës
- Z. Osman Hajdari, drejtor
Spitali i Përgjithshëm në Prizren
- Z. Hilmi Shala, drejtor
Spitali i Përgjithshëm në Gjakovë
- Z. Fahri Hasani, drejtor
Spitali i Përgjithshëm në Pejë
- Z. Afrim Cana, drejtor
Spitali i Përgjithshëm në Gjilan
- Z. Habit Hajredini, drejtor
Zyra për Qeverisje të Mirë - Zyra e Kryeministrit

Prishtinë, më 9 qershor 2026

Qëllimi i raportit

Shëndeti mendor dhe çrregullimet mendore paraqesin një nga sfidat e shëndetit publik. Prandaj, në pajtim me nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (në tekstin e mëtejshëm: MKP), gjatë vitit 2025, vizitoi institucionet e shëndetit mendor, ku fokus i veçantë iu kushtua departamenteve psikiatrike në kuadër të spitaleve regjionale në Prizren, Gjakovë, Pejë dhe Gjiilan, si dhe dhomave të dedikuara për të burgosur në Spitalin e Përgjithshëm në Prizren dhe në Pejë. Qëllimi i këtyre vizitave ishte vlerësimi nëse personat me probleme të shëndetit mendor trajtohen me dinjitet dhe nëse, në përgjithësi, respektohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare që garantohen me Kushtetutë dhe zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës.

Ky raport ofron një pasqyrë të kushteve aktuale në katër departamentet psikiatrike dhe synon t'i identifikojë sfidat ekzistuese, si dhe të propozojë rekomandime konkrete për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve të shëndetit mendor për personat me probleme mendore, duke siguruar qasje të barabartë dhe pa diskriminim për të gjithë.

Baza ligjore

1. Avokati i Popullit, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës (më tej: Kushtetuta) dhe Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit¹ (në tekstin e mëtejshëm: Ligji për Avokatin e Popullit), pos të tjerash, i ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- *“Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike (neni 132, paragrafi 1, i Kushtetutës);*
- *Avokati i Popullit mund të japë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore (neni 135, paragrafi 3, i Kushtetutës);*
- *të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, i Ligjit për Avokatin e Popullit);*
- *të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, i Ligjit për Avokatin e Popullit);*
- *t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, i Ligjit për Avokatin e Popullit).”*

¹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr.16/, 26 qershor 2015¹, Prishtinë: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10922>.

Korniza ligjore dhe analiza e çështjes

2. Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara² garanton të drejtat dhe liritë e të gjithë personave me aftësi të kufizuara, me fokus në barazi, respektimin e dinjitetit dhe mosdiskriminimin në fusha të ndryshme, përfshirë edukimin, shëndetin dhe shërbimet sociale. Personat me aftësi të kufizuara përfshijnë individët me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat, në ndërveprim me barriera të ndryshme, mund ta pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri, njësoj sikurse pjesën tjetër të shoqërisë.
3. Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara siguron qasje në shërbime shëndetësore cilësore për personat me aftësi të kufizuar, pa asnjë diskriminim.
4. Ligji nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor³ synon mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit mendor, parandalimin e problemeve që lidhen me të, garantimin e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me çrregullime mendore.
5. Neni 10 i Ligjit për Shëndetin Mendor përcakton shërbimet shëndetësore, nëpërmjet të cilave ofrohet kujdesi për shëndetin mendor, siç janë: kujdesi shëndetësor parësor, dytësor dhe tretësor. Neni 12 i këtij ligji përcakton shërbimet e shëndetit mendor të nivelit dytësor, në të cilin bëjnë pjesë departamentet e psikiatrisë në kuadër të spitaleve të përgjithshme; qendrat e shëndetit mendor, shtëpitë integruese në bashkësi, si dhe Qendra për Integrim, Rehabilitim, Risocializim të të Sëmurëve Kronikë Psikiatrikë në Shtime.
6. Neni 15 i Ligjit për Shëndetin Mendor thekson se shërbimet e shëndetit mendor të kujdesit dytësor dhe tretësor shëndetësor menaxhohen në bazë të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës⁴.
7. Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, përkatësisht neni 19 - Kujdesi dytësor shëndetësor - thekson se organizimi dhe veprimtaria e institucioneve shëndetësore të kujdesit dytësor përcaktohet me akte nënligjore të nxjerra nga Ministria.
8. Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2025 Kushtet dhe Procedurat për Ushtrimin e Veprimtarisë Shëndetësore Spitalore dhe Qendrave Rehabilituese, në nenin 24 përcakton shërbimet shëndetësore themelore në spitalin e përgjithshëm, por nuk e përfshin shërbimin e shëndetit mendor.
9. Neni 30 i Ligjit për Shëndetin Mendor, lidhur me monitorimin e jashtëm të shërbimit të shëndetit mendor, thekson: *“Avokati i Popullit, nëpërmjet mekanizmave të tij, vëzhgon rregullisht me anë të inspektimeve periodike, respektimin e të drejtave dhe të standardeve që u ofrohen personave me çrregullime mendore në mjediset e shërbimit të shëndetit mendor.”*
10. MKP-ja vizitoi departamentet e psikiatrisë në kuadër të spitaleve të përgjithshme në Prizren, Pejë, Gjakovë, Gjilan, me qëllim të mbledhjes së informatave, vlerësimit të kushteve, trajtimit të pacientëve, furnizimit me barna dhe sfidat e tjera me të cilat

² Kombet e Bashkuara, *Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara*, miratuar më 13 dhjetor 2006, hyri në fuqi më 3 maj 2008, në dispozicion në: <https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/convention-rights-persons-disabilities>.

³Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr. 33/23, 2015, Prishtinë: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11229>.

⁴ Shih, Statuti (QRK) nr. 01/2023 i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës <https://shskuk.rks-gov.net/SHSKUK/ShskukStatus>

ballafaqohet stafi etj.

11. Gjatë vizitave në katër departamentet psikiatrike, MKP-së iu ofrua bashkëpunim i plotë dhe qasje e papenguar në të gjitha hapësirat, në dosje shëndetësore, si dhe iu mundësua intervistimi i pacientëve, pa praninë e personelit shëndetësor.
12. Pas vizitave të realizuara, Avokati i Popullit organizoi tryezë diskutimi me përfaqësues të institucioneve të shëndetit mendor të nivelit dytësor dhe tretësor, si dhe me përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë, të ShSKUK-së dhe të organizatave vendore e ndërkombëtare, për të diskutuar çështjet e identifikuara nga Avokati i Popullit, si dhe sfidat me të cilat përballen institucionet e shëndetit mendor në trajtimin e rasteve.⁵

Përmbledhje e vizitave të realizuara

13. **Departamenti i Psikiatrisë në Prizren** - është i ndarë në dy pavijone: njëri për gjininë femërore, me kapacitet prej 10 shtretërve, dhe tjetri për gjininë mashkullore, gjithashtu me kapacitet prej 10 shtretërve. Departamenti posedon edhe një dhomë të veçantë, e cila përdoret për programin e metadonit, një sallë televizori që shërben për aktivitete, si dhe dy dhoma të Urgjencës Psikiatrike, të cilat janë jashtë funksionit. Gjatë kohës së vizitës, ekipi u informua se ishin të hospitalizuar 12 pacientë.
14. **Trajtimi** - për sa u përket rasteve të hospitalizuara, sipas njoftimit të drejtorit, pacientët e hospitalizuar plotësojnë një formular pëlqimi, i cili është formular i përgjithësuar që përdoret në të gjitha repartet e Spitalit të Përgjithshëm të Prizrenit. MKP-ja konstatoi se, në përgjithësi, departamentet psikiatrike nuk kanë formular specifik të pëlqimit për trajtim dhe hospitalizim të pacientëve psikiatrikë. Ekipi gjithashtu vërejti se Karta e të drejtave të pacientit nuk ishte e vendosur në asnjë hapësirë të repartit. Në Repartin e Psikiatrisë ofrohet Terapia Mbajtëse me Metadon (TMM), ndërsa gjatë kohës së vizitës ekipi u informua se në këtë program ishin të përfshirë rreth 15 raste. Sipas pohimeve të drejtorit dhe stafit, nuk pati probleme lidhur me furnizimin me barna, e as me cilësinë dhe sasinë e ushqimit.
15. **Kushtet e akomodimit** - u vërejt se kushtet nuk janë të mira për shkak të mungesës së renovimeve ndër vite. Banjat për higjienën personale të pacientëve nuk janë funksionale, ndërsa salla e qëndrimit ditor ka vetëm një televizor dhe asnjë pajisje tjetër. Dhomat e dedikuara për urgjencë psikiatrike nuk janë funksionale, pasi nuk i plotësojnë kushtet për izolimin e pacientëve. Dhoma për intervistimin e pacientëve është pa dritare, pa ndriçim artificial dhe jo e përshtatshme për trajtimin e rasteve akute psikiatrike. Në përgjithësi, reparti është i demoluar. Kutia e ankesave për pacientët është jashtë funksionit dhe është nën menaxhimin e spitalit të përgjithshëm.
16. **Stafi shëndetësor** - përbëhet nga 10 infermierë, 1 kryeinfermier dhe 5 mjekë psikiatër, ndërsa nuk ka psikolog klinik. Shërbimet sociale duhet të ofrohen nga punëtori social i Qendrës së Shëndetit Mendor. Stafi shëndetësor mban trajnime të rregullta në kuadër të edukimit të vazhdueshëm, por sipas pohimeve të tyre, nuk zhvillohen trajnime adekuate për specifikat e punës në repart dhe për menaxhimin e rasteve psikiatrike në përgjithësi.
17. **Reparti i Kirurgjisë i Spitalit të Prizrenit** - ka në dispozicion vetëm një dhomë me dy shtretër, e cila është e dedikuar vetëm për personat e privuar nga liria dhe i plotëson

⁵<https://oik-rks.org/2026/02/27/avokati-i-popullit-mbajti-tryeze-diskutimi-per-trajtimin-e-personave-me-cregullime-mendore-ne-sherbimin-e-kujdesit-shendetesor-dytesor/>

kushtet për vendosjen e personave të kësaj kategorie.

18. **Departamenti Psikiatrik në Pejë** - ka 7 dhoma aktive me nga dy shtretër, 1 dhomë jashtë funksionit (pasi ishte djegur nga një pacient para dy vjetësh), 1 dhomë të veçantë që përdoret për programin e metadonit, sallën e qëndrimit ditor që shërben për aktivitete, si dhe 1 dhomë izolimi për një person. Reparti posedon një hapësirë të jashtme që shfrytëzohet si shëtitore për pacientët e hospitalizuar, e cila ka nevojë për rregullim dhe përshtatje për pacientët psikiatrikë. Gjatë kohës së vizitës, zhvilluam biseda me 7 pacientë të hospitalizuar, të cilët nuk raportuan ndonjë shqetësim.
19. **Trajtimi** - për sa u përket rasteve të hospitalizuara, u vërejt se nuk ekziston një formë e shkruar e pëlqimit për trajtim dhe hospitalizim. Gjithashtu u vërejt se Karta e të drejtave të pacientit nuk ishte e vendosur në asnjë hapësirë të repartit. Sipas informatave të stafit shëndetësor, ka pacientë që qëndrojnë për trajtim me urdhër të Gjykatës, ku qëndrimi i tyre mund të zgjasë deri në 3 muaj në repart. MKP-ja analizoi dosjet e pacientëve dhe konstatoi se reparti posedon vetëm historitë e pacientëve. Sipas njoftimit të shefit të repartit, ata përballen me mungesë të barnave, ku sipas listës esenciale, rreth 70% e barnave mungojnë. Pacientëve u ofrohen tri shujta ushqimore, ndërsa nuk paraqiten ankesa lidhur me cilësinë dhe sasinë e ushqimit.
20. **Kushtet** - ekipi u informua se para disa muajve u kryen renovime, ku u gëlqerosën hapësirat dhe u rregulluan muret. U vërejt se nuk ka ujë të ngrohtë për pastrimin e pacientëve, problem i cili, sipas stafit dhe pacientëve, ka disa muaj që ekziston. Dhoma e izolimit, e cila përdoret për rastet agresive dhe vështirë të menaxhueshme, si dhe për rastet e paraburgimit me probleme mendore (deri në 48 orë), ngjan me një qeli burgu dhe nuk i plotëson kushtet për trajtimin e rasteve me çrregullime të rënda mendore në situata krize, pasi paraqet rrezik për vetëlëndim.
21. **Stafi shëndetësor** - përbëhet nga 9 infermierë, 3 mjekë psikiatër, 1 pastrues. Punëtori social i QShM në Pejë i mbulon nevojat edhe për Repartin Psikiatrik, ndërsa nuk ka psikolog klinik. Sipas informatave të siguruara, stafi shëndetësor nuk ka trajnime adekuate për specifikat e punës në repart, p.sh. me menaxhimin e rasteve të rënda mendore e që janë agresive.
22. **Reparti i Kirurgjisë i Spitalit të Pejës** - ka në dispozicion 2 dhoma me nga 2 shtretër, të cilat i shërbejnë Njësisë Shëndetësore të Qendrës së Paraburgimit në Pejë dhe janë të dedikuara vetëm për personat e privuar nga liria. Ekipi i vizitoi këto dhoma dhe kontrolloi librin e evidencave të zyrtarëve korrektues, ku u evidentuan 2 raste psikiatrike, të cilat qëndruan mbi 3 muaj. Lidhur me këto raste, u informuam se të njëjtët nuk dolën në shëtitje asnjëherë, situatë e cila është e papranueshme dhe në kundërshtim me të drejtat e njeriut. Gjatë vizitës ishte i pranishëm vetëm një i paraburgosur, i cili ishte hospitalizuar për shkak të problemeve me veshët, i cili nuk raportoi asnjë ankesë.
23. **Departamenti i Psikiatrisë në Gjakovë** – edhe në këtë departament psikiatrik nuk ka formë të shkruar të pëlqimit për trajtim dhe hospitalizim, ndërsa rastet e varësisë nga droga, alkooli dhe substanca të tjera e plotësojnë formularin e pëlqimit. Si sfidë që u potencua nga stafi shëndetësor ishte qëndrimi afatgjatë (deri në 1 vit) i disa rasteve për shkak se nuk kanë përkujdesje familjare, pra nuk kanë ku të kthehen.
24. Sipas njoftimit të shefit të repartit, ata ballafaqohen me mungesë të barnave, ku sipas listës esenciale, rreth 70% të barnave u mungojnë. Pra, pacientët detyrohen vetë t'i blejnë

barnat. Pacientëve u ofrohen tri shujta ushqimore. Lidhur me këtë çështje, nuk u paraqitën ankesa për sa i përket cilësisë dhe sasisë së ushqimit.

25. **Kushtet** – kapaciteti i Repartit Psikiatrik është 26 shtretër. Sipas informatave të stafit, renovime u kryen para disa viteve, ku u ndërruar dyert, dritaret dhe kulmi. Tri dhoma të kujdesit intensiv psikiatrik janë jofunksionale për shkak të mungesës së infrastrukturës adekuate. Sipas informatave të shefit të repartit, shpeshherë ka raste që sillen nga policia për 48 orë për trajtim dhe mbikëqyrje gjatë gjithë kohës.
26. **Stafi shëndetësor** – përbëhet nga 13 infermierë dhe 5 mjekë psikiatër; nuk ka psikolog klinik, ndërsa punëtori social i QShM-së në Gjakovë i mbulon nevojat edhe për Repartin Psikiatrik. Sipas drejtorit, shpesh ballafaqohen me raste që qëndrojnë për muaj të tërë në spital për shkak se nuk kanë strehim.
27. **Trajtimi në Departamentin e Psikiatrisë në Gjilan** - kapaciteti i Repartit Psikiatrik është 15 shtretër, ku ishin të pranishëm 9 pacientë të hospitalizuar. Gjatë intervistave me disa prej tyre, nuk u raportua asnjë ankesë lidhur me trajtimin dhe ushqimin. Rastet e hospitalizuara nuk kanë një formë të shkruar të pëlqimit për trajtim dhe hospitalizim. Sipas informatave të drejtorit, nga janari deri në ditën e vizitës së MKP-së, rreth 30 raste u trajtuan për 48 orë me urdhër të gjykatës dhe kanë qenë nën mbikëqyrjen e policisë. Nga muaji qershor i vitit 2012, në psikiatri zbatohet edhe programi i metadonit. MKP-ja vërejtë se ishte e vendosur Karta e të drejtave të pacientit, si dhe kutia e ankesave, e cila menaxhohet nga spitali i përgjithshëm.
28. **Trajtimi** - bëhet me barna dhe seanca individuale me psikologun. Për shkak të hapësirave të kufizuara të repartit, nuk mund të realizohet asnjë aktivitet me pacientë të hospitalizuar. Nuk ka probleme rreth furnizimit me barna.
29. **Kushtet** - Reparti i Psikiatrisë u hap në vitin 2008 dhe u parapanë dy kate. Mirëpo, për shkak të disa renovimeve në Spitalin e Përgjithshëm të Gjilanit, në hapësirat e dedikuara për aktivitete për rastet psikiatrike u vendos Reparti i Neurologjisë. Sipas njoftimit të drejtorit të Repartit të Psikiatrisë, pritet të vazhdojnë renovimet në spital dhe hapësirat e Psikiatrisë do të kufizohen edhe më shumë, gjë që mund të rrezikojë edhe konfidencialitetin gjatë trajtimit të rasteve psikiatrike.
30. **Stafi shëndetësor** - përbëhet nga 3 psikiatër, 1 psikolog klinik dhe 8 infermierë. Në katin ku është vendosur Reparti i Neurologjisë janë 4 neurologë, ndërsa gjatë natës neurologët dhe psikiatrit kujdestarojnë me radhë për të dy repartet.

Gjetjet dhe konstatimet e Avokatit të Popullit

31. Avokati i Popullit konstaton se në të gjitha departamentet psikiatrike, trajtimi konsiston në farmakoterapi, nuk ka qasje shumëdisciplinore, ashtu siç përmendet në Ligjin nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor⁶. Pra, shumica e institucioneve nuk ofrojnë gjithmonë të gjitha shërbimet e nevojshme të trajtimit, të cilat janë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe që kërkohen për ofrimin e shërbimeve bashkëkohore të psikiatrisë spitalore.

⁶ Ligji nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor, në nenin 5, ka përcaktuar parimet themelore të kujdesit në shërbimet e shëndetit mendor mbi të cilat mbështeten të gjitha dispozitat e tij; ku në paragrafin 1.4 thekson: “Ofrimi i kujdesit për personat me çrregullime mendore nga ekupe multidisiplinore që i përgjigjen në mënyrë komplekse nevojave mjekësore, psikologjike, sociale dhe të rehabilitimit.”

32. Në departamentet psikiatrike në Prizren, Pejë, Gjakovë nuk është i punësuar psikologu klinik, përpos në Departamentin e Psikiatrisë në Gjiilan, duke e ditur që edhe Ligji për Shëndetësi e përcakton si profesionist shëndetësor psikologun klinik⁷. Për shkak të mungesës së dhomave të aktiviteve dhe kufizimeve të tjera, terapitë okupacionale dhe shërbime të tjera terapeutike nuk mund të ofrohen.
33. Për sa i përket pëlqimit për trajtim, Avokati i Popullit konstaton se, në përgjithësi, në departamente psikiatrike në katër regjione nuk kanë formë specifike të pëlqimit për trajtim dhe hospitalizim për pacientët psikiatrikë. Në të shumtën e rasteve, personave të hospitalizuar me probleme të shëndetit mendor nuk u jepet mundësia e dhënies së pëlqimit me shkrim apo e drejta për refuzim të trajtimit. Për sa i përket së drejtës për trajtim, e njëjta situatë u konstatua edhe në raportin e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës për vizitat në Kosovë në vitin 2015⁸ dhe 2020⁹, ku theksohet: *“Pranimi i një personi në një institucion psikiatrik mbi baza të pavullnetshme, qoftë në kontekstin e një procesi gjyqësorë civil apo penal, nuk duhet të përjashtojë marrjen e pëlqimit të informuar për trajtim. Çdo shmangie nga ky parim duhet të bazohet në ligj dhe të lidhet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe duhet të shoqërohet me masa mbrojtëse të përshtatshme.”*
34. Në departamentet psikiatrike në Prizren, Gjakovë dhe Pejë nuk e kanë të vendosur Kartën e të drejtave dhe përgjegjësi të pacientit. Ajo është e vendosur vetëm në Gjiilan. Sipas deklarimeve të stafit të mesëm, nuk kanë trajnime adekuate për menaxhimin e rasteve kronike psikiatrike, të cilat janë agresive dhe vështirë të menaxhueshme.
35. Avokati i Popullit konstaton se Kutia e ankesave në Prizren është jashtë funksionit.
36. Në Departamentin e Psikiatrisë në Pejë, Avokati i Popullit konstaton se dhoma e izolimit i ngjan qelisë së burgut dhe nuk i plotëson kushtet për trajtimin e rasteve me probleme të rënda mendore në raste krizash, pasi paraqet rrezik për vetëlëndim.
37. Në Repartin e Kirurgjisë të Spitalit të Pejës dhe të Prizrenit, dhomat që janë të dedikuara për personat e privuar nga liria nuk janë të përshtatshme për qëndrim afatgjatë të rasteve psikiatrike, pasi nuk kanë mundësi të dalin për shëtitje dhe dhomat ngjajnë me qeli të burgut.
38. Avokati i Popullit konstaton se në Departamentin e Psikiatrisë në Prizren dhe në Gjakovë, dhomat e kujdesit intensiv psikiatrik nuk janë funksionale, për shkak të mungesës së infrastrukturës adekuate.
39. Avokati i Popullit konstaton se departamentet psikiatrike aktualisht nuk kanë kushte për t'u pastruar pacientët e hospitalizuar.
40. Avokati i Popullit konstaton se, në përgjithësi, kushtet në Departamentin Psikiatrik në Prizren nuk janë të mira, për shkak se me vite nuk ka pasur renovime. Dhoma e intervistimit të pacientit është pa dritare, pa dritë artificiale dhe jo e përshtatshme për trajtimin e rasteve akute psikiatrike. Në përgjithësi, reparti është i demoluar.

⁷ Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, përkatësisht Neni 69, i përcakton profilet e profesionistëve shëndetësorë, ku në paragrafin 1.3 e thekson psikologun klinik (specialist, sub-specialist).

⁸ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, raporti për vizitën në Kosovë në vitin 2015, i publikuar në vitin 2016, paragrafi 101. Për më shumë: <https://rm.coe.int/16806a1efc> (4.7.2018).

⁹ Shih raportin e KPT-së, paragrafi 145, për vizitën e fundit në Kosovë, i publikuar më 23 shtator 2021: <https://www.coe.int/en/web/cpt-/the-cpt-publishes-report-on-kosovo>.

41. Avokati i Popullit konstaton se departamentet psikiatrike në Pejë dhe në Gjakovë ballafaqohen me mungesë të barnave, ku sipas listës esenciale, rreth 70% të barnave u mungojnë.

42. Avokati i Popullit konstaton se stafi i mesëm i angazhuar në departamentet psikiatrike me vite nuk kanë pasur trajnime adekuate për menaxhimin e rasteve kronike psikiatrike në raste krizash.

Në bazë të të gjeturave të Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës gjatë realizimit të vizitave, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe me nenin 17, paragrafi 7, të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Ministrisë së Shëndetësisë dhe Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës:

- 1. Në departamentet psikiatrike në Prizren, Gjakovë, Pejë është e nevojshme të angazhohen psikologë klinikë dhe të mundësohet qasja shumëdisciplinore për trajtimin e personave me probleme mendore.*
- 2. Departamente psikiatrike në katër regjione të kenë formë specifike me shkrim të pëlqimit për trajtim dhe hospitalizim për pacientët me probleme të shëndetit mendor.*
- 3. Në departamentet psikiatrike në Prizren, Gjakovë dhe Pejë, Karta e të drejtave dhe përgjegjësisë të pacientit të vendoset në vende të dukshme për pacientët e hospitalizuar.*
- 4. Në Departamentin Psikiatrik në Prizren të funksionalizohet kutia e ankesave për pacientët.*
- 5. Departamenti Psikiatrik në Prizren të rinovohet në përgjithësi, pasi është i demoluar (shih konstatimet).*
- 6. Në Departamentin e Psikiatrisë në Pejë të krijohen kushtet e përshtatshme në dhomën e izolimit për trajtimin e rasteve me probleme të rënda mendore në raste krizash.*
- 7. Në Departamentin e Psikiatrisë në Prizren dhe në Gjakovë, dhomat e kujdesit intensiv psikiatrik të rinovohen me infrastrukturë adekuate dhe të funksionalizohen.*
- 8. Në katër departamentet psikiatrike të rregullohen dhomat e qëndrimit ditor¹⁰, në mënyrë që të mund të ofrohet trajtim efikas dhe me qasje shumëdisciplinore, ku mund të zhvillohen aktivitete terapeutike individuale, grupe etj.*
- 9. Në katër departamentet psikiatrike të krijohen kushtet për pastrimin e pacientëve.*
- 10. Departamentet psikiatrike në Pejë dhe në Gjakovë të furnizohen mjaftueshëm me barna për pacientët e hospitalizuar.*
- 11. Të organizohen trajnime adekuate për menaxhimin e rasteve kronike psikiatrike dhe të rasteve të krizës për stafin shëndetësor në departamentet psikiatrike.*

¹⁰ Dhomat e qëndrimit ditor ndihmojnë për mbështetje sociale dhe psikologjike, ku mund të zhvillohen terapi grupe, individuale, trajnime për aftësi sociale që do t'i ndihmojnë pacientët t'i rikthejnë funksionet sociale dhe ta përmirësojnë cilësinë e jetës dhe gjithashtu mund të jetë edhe mbështetje për familjarët. Pra, këto dhoma krijojnë një ambient të sigurt, të strukturuar dhe terapeutik për pacientët e hospitalizuar.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqes atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara ne pajtim me ligj.”) dhe në pajtim me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritete, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerri lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Naim Qelaj
Avokat i Popullit

